



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 54 Date 22.02.2017

“ Për
Miratimin e lejes për përdorim uji Teknologjik”
“ DEJVIS B.A” sh.p.k”.

Në mbështetje të neneve 7 pika 2 , nenit 50, 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” , vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe kërkesës së subjektit “DEJVIS B.a” sh.p.k , me propozim te A.B.U Mat;
Këshilli i Basenit Ujor Mat;

V e n d o s i :

1. Miratimin e “Lejes për përdorim uji Teknologjik/larje inerte”, Pus shpimi ekzistues sipas studimit të paraqitur nga subjekti “ DEJVIS B.A” sh.p.k me administrator z.Besnik Allamani, me këto të dhëna:
 - Vendndodhja e pus-shpimit , Njesia Administrative Milot, Rethi Kurbin, Qarku Lezhë
 - Prurja mesatare : 0.02 m3/s
 - Sasia e ujit për përdorim: 0.004 m3/s
 - Kordinatat e burimit ujore:

Kordinatat		Thellësia
X	Y	
46 17 668	43 92 942	15

2. Ngarkohet A.B.U. Mat për zbatimin e këtij vendimi .

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast NIKOLLA



KRYETARI FK A.B.U. MAT

Eduard NDRECA



265

264